



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0634

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Kimete Gashi dhe Batisha Ibrahim - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së (OE) N.P.T "Haxhijaha" Sh.p.k. dhe ankesa e (OE) "Agri Bau" SH.P.K, kundër Njoftimit për kontratë ose me dokumentet e tenderit, lidhur me aktivitetin e prokurimit "132 Furnizimi me mekanizëm bujqësor- LOT1 dhe LOT2" me numër të prokurimit 616-24-5854-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës, më 19/09/2024, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e N. P.T "Haxhijaha" Sh.p.k., me nr. 2024/0634, e datës 15/07/2024 dhe ankesa e OE "Agri Bau" SH.P.K me nr. 2024/0653 e datës 18/07/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit "132 Furnizimi me mekanizëm bujqësor- LOT1 dhe LOT2", me numër të prokurimit 616-24-5854-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prishtinës.
2. Anulohet njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "132 Furnizimi me mekanizëm bujqësor- LOT1 dhe LOT2", me numër të prokurimit 616-24-5854-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komunës së Prishtinës, ndërkaq obligohet AK që të bëjë përmirësimet e nevojshme në dosjen e tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.
4. Meqenëse ankesat e OE-ve ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 24.10.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “132 Furnizimi me mekanizëm bujqësor- LOT1 dhe LOT2”, me numër të prokurimit 616-24-5854-1-1-1.

Kërkesa për rishqyrtim dt.10.07.2024 është parashtruar nga N. P.T "Haxhijaha" kundër njoftimit për kontratë të AK-së. Me datën 15.07.2024 kërkesë për rishqyrtim ka parashtruar edhe operatori ekonomik “Agri Bau” SH.P.K

Autoriteti kontraktues me datën 12. 07. 2024 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të operatorëve ekonomik ankues.

Kundër vendimit të cituar si më sipër me 15.07.2024 operatori ekonomik N. P.T. "Haxhijaha" Sh.p.k.” ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/0634 (Nr. protokolli).

Kundër vendimit të cituar si më sipër me 18.07.2024 operatori ekonomik “Agri Bau SH.P.K” ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/0653 (Nr. protokolli).

Në fazën e shqyrtimit paraprak:

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP. Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP-së.

(b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 26.07.2024 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

- ankesat të aprovohen si të bazuara dhe,
- aktiviteti i prokurimit të kthehet në ri tenderim.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues N. P.T. "Haxhijaha" në ankesën Nr. 634/24 janë parashtruar si në vijim:

Neni 1 LPP thotë se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me të drejt të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoritetit kontraktues në Kosovë. AK-ja në përpilimin e kësaj dosjeje së këtij tenderi përkatësisht tek kërkesat e tyre tek FTD-ja - Fleta e dhënave të tenderit si dhe tek Aneksi 1 që atë beje me specifikimet teknike të detyrueshme, janë bazuar në një burim i veçantë dhe kështu e favorizojnë një operator të caktuar ekonomik për pikat të cilat të i përmendim më poshtë. Fleta e të dhënave të tenderit në pikën 9.1&9.2 që ka të beje me kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale për pikën Nr. 3 ku kanë kërkuar, citoj: OE duhet të ketë një agronom të diplomuar dhe të licencuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për dhënien e këshillave për fermer dhe si dëshmi kanë kërkuar: Të dorëzohet diploma e fakultetit të bujqësisë dhe certifikata e këshilltarit bujqësor e lëshuar nga MBPZHR kontrata e punës minimum 1 vit sa zgjat periudha e monitorimit.

Kjo kontratë publike kornize është e natyrës Furnizim dhe vendosja e këtij kriteri tek FTD-ja është bere për qëllim të eliminimit të OE të interesuar për këtë aktivitet të prokurimit dhe të favorizoj një OE të caktuar, e kjo bene shkelje të LPPK-se nënë 1, 6 dhe 7. Sikurse që është lartpërmendur në këtë kontratë kemi të bëjmë me një kontratë e cila është e natyrës Furnizim e jo me Shërbim, duke kërkuar një Agronom për dhënien e këshillave për fermer. Agronomi me dhënie e këshillave bene shërbim e jo furnizim. Poashtu kërkon kontratë pune min. 1 vite gjë që është e pakuptim ngase nuk mund të obligosh një OE ta përpiloj kontratë me punëtor vetëm për një projekt të caktuar për interesat e autoritetit kontraktues, e për cilat kërkesa e tyre është jashtë natyrës së kontratës. Në përgjigje e pranuar nga AK-ja për kërkesën për rishqyrtimin për pretendimin tone të kësaj çështjeje AK-ja pretendon se është nevoja e njësisë kërkuese për staf profesional. E ritheksoj që kjo kontratë ka të bej me Furnizim e jo me Shërbim, pajisjet e kërkuara janë pajisjet mekanike të cilën përdoren për kultivimin e tokës bujqësore. Detyra e agronomit ka të beje me dhënie e këshillave mbi kulturat bujqësore, rritja e efikasiteti të prodhimit ejt. E asnjëherë nuk është detyrë e Agronomit të shpjegoj apo të jep këshillat si të përdoret një mekanizëm bujqësor. Për dhënien e një këshille të tillë do të duhet të kërkohej një inxhinier i makinerisë i cili do të shpjegonte funksionalitetin e një makinerie.

Për më tepër nëse njësisia kërkues ka nevojë për staf profesional janë dispozitat të tjera ligjore të cilat e lejojnë AK-ne të kërkoj përmes thirrjes publike për staf profesional të cilat do ofronin shërbimet sipas kërkesës së njësisë kërkuese. Andaj në kërkojmë nga AK-ja që të largohet ky kusht në dosje të tenderit, të respektohet natyra e kontratës e që ka të beje me furnizim e jo shërbim, e në atë mënyrë të lejohet qasja sa më e gjere e OE të interesuar për këtë aktivitet të prokurimit.

2. Tek FTD-ja tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, njëra nga kërkesat e AK-se kërkohet katalogu por në tekstin e përpiluar nga AK-ja janë disa pika të pakuptimta, citoj:... pasi të vlerësohen lidhur me cilësinë e pajisjeve që do të ofrojnë. Cilësia e pajisjeve duhet të jete e lart dhe të njohura nga kompanitë prodhuese të pranueshme për cilësi të prodhimit. Fillimisht si e kemi lartpërmendur kërkesa e AK-se në dosje të tenderit është e pakuptimtë e për të cilën AK-ja ka vendosur qëllimisht që komisioni vlerësues të beje vlerësimin e ofertuesve si të duan ata. Pretendimi i ynë i ngritur në formë të pyetjeve ve në pah lëshimet që njësisia kërkuese apo zyrtar të tjerë i kanë vendosur për qëllim për të eliminuar konkurrencën ndërmjet OE të interesuar në këtë aktivitet të prokurimit. Andaj në kërkojmë nga AK-ja të beje rishqyrtimin e dosjes së tenderit, ta riformuloj kërkesën e tyre ngase një tekst i tillë i përpiluar në kërkesë të tyre është i pakuptimit e cila nga komisioni vlerësues do të vlerësohet në mënyrë jo korrekte.

3. Tek kërkesa Nr.5 tek FTD-ja kërkon qe se paku 3 here gjate procesit te punës OE te dërgoj një specialist. Një kërkesë e tillë prape sikurse ne piken Nr. 1 ka te beje jashtë natyrës se kësaj kontrate pra me shërbim e jo me furnizim. Andaj ne kërkojmë nga AK-ja qe te beje rishqyrtimin e dosjes se tenderit dhe te largoj një kërkesë te tillë nga FTD-ja. AK-ja ne kërkesën për rishqyrtim ka dhënë përgjigje për këtë pike se bashku edhe për piken 1. Ky pretendim i yni sikurse edhe ai i pikës 1 ka te beje jashtë natyrës se kontratës. Andaj pretendimi i yni rreth kësaj pike është i njëjti sikurse ai i pikës 1. Tek Aneksi 1 qe ka te beje me specifikat teknike AK-ja është bazuar e referuar nga një burim i veçantë duke përpiluar specifikat teknike te pakuptimta, jo te sakta e duke mos kërkuar minimale/maksimalet te lejuara ose se paku te kerko pajisje ekuivalente por kërkon te një prodhuesi te veçantë.

Poashtu tek këto specifikat teknike janë te shkruara/kërkuar disa paramasa te pakuptimta për te cilat do i trajtojmë më poshtë: -Gjerësia: 150mm – një rimorkio me kapacitet 3.5m³ nuk mundet te këtë një gjerësi te tillë sikurse kërkesa e AK-se, nëse behet shendrimi i njësive matëse atëherë i bie qe gjerësia e kërkuar e rimorkios duhet te jete 0.15metra!? Si mund te jete një rimorkio 0.15metra!?

-Gjatësia 320mm – një rimorkio me kapacitet 3.5m³ nuk mundet te këtë një gjatësi te tillë sikurse kërkesa e AK-se, nëse behet shendrimi i njësive matëse atëherë i bie qe gjatësia e kërkuar e rimorkios duhet te jete 0.32metra!? Si mund te jete një rimorkio 0.32metra!?

-Lartësia anësore 44mm – një rimorkio me kapacitet 3.5m³ nuk mundet te këtë një lartësi te tillë sikurse kërkesa e AK-se, nëse behet shndërrimi i njësive matëse atëherë i bie qe lartësia e kërkuar e rimorkios duhet te jete 0.044metra!? Si mund te jete një rimorkio 0.044metra!?

-Janë dy lloje te sistemit te shpërndarës tek këto rimorkio e te cilat dallojnë ne çmim: pallet dhe auger. Te dyjat janë me 2 sisteme te fluturave vertikale. Ne kërkojmë nga AK-ja qe te saktësoj edhe këtë detajet ngase është njeri nga kryesoret ne specifikat teknike te këtyre rimorkiove. Nuk mund te vlerësohen gjate ofertimit si te njëjta. Shpërndarje e tyre është e ndryshme, andaj kërkojmë nga AK-ja te beje kërkesë ne baze te kërkesave te fermerëve.

-Sistemi i komandimit e kërkojnë te jete para me mundësi kontrolli nga traktori. Sistemi a duhet te jete elektrohidraulik pasi e kërkojnë te komandohet nga traktori apo duhet te jete sistemi standard i komandimit!? Ne kërkojmë te saktësohet edhe kjo pike ngase edhe këtu ofertat janë te ndryshme ne çmim.

Përgjigje e Autoritetit Kontraktues në pretendimet ankimore të OE N. P.T. "Haxhijaha"

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe paralogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, paralogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese. Për këto arsye është refuzuar si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Lidhur me pretendimin nr. 1 dhe nr. 3: kërkesat lidhur me agronom dhe specialist janë kërkesa të domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës që synohet të lidhet për këtëj aktiviteti të

prokurimit. Kërkesat për staf profesional nuk janë të ndërlidhura me llojin e kontratës për shërbime, për punë apo për furnizim por janë të ndërlidhura me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe nevojat e njësisë kërkuese si dhe me dispozitat ligjore në fuqi të ndërlidhura me këtë çështje. Në rastin konkret këto kërkesa jo vetëm që janë të nevojshme por janë të domosdoshme dhe për këto arsye pretendimet ankimore të parashtruesit janë të pabazuara në tërësi.

Lidhur me pretendimin nr. 2: duhet theksuar që pretendimi nr. 2 në fakt nuk është pretendim por manifestohet në formë të disa pyetjeve sqaruese që parashtruesi ka drejtuar te AK. Me qëllim të respektimit të parimeve themelore të prokurimit publik për transparencë dhe efikasitet, AK e njofton parashtruesin se pyetjet e tilla sqaruese duhet të parashtrohen duke përdorur formularin adekuat të KRPP për sqarime shtesë për AK dhe jo formularin F02 të kërkesës për rishqyrtim i cili shërben për qëllime krejt tjera.

Lidhur me pretendimin nr. 4: të gjitha specifikat teknike të detyrueshme janë hartuar në mënyrë të saktë, konkrete dhe në përputhje të plotë me qëllimin e aktivitetit të prokurimit si dhe nevojat e njësisë kërkuese. Prandaj këto specifika si të tilla janë absolutisht të domosdoshme për të realizuar me sukses kontratën që synohet të lidhet përmes këtij aktiviteti të prokurimit. Parashtruesi nuk e kontestuar në mënyrë të argumentuar këtë fakt. Ndërsa sa i përket pyetjeve sqaruese të parashtruesit, vlen përshtatshmërisht përgjigja për pretendimin nr. 2. Rrjedhimisht edhe ky pretendim është i pabazuar. Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Agri Bau Sh.P.K.” ne ankesën Nr. 653/24 janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi ankimor 1: OE ankues pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe RrPP duke vendosur kërkesë për Agronom në këtë aktivitet të prokurimit i cili është furnizim me pajisje.

Pretendimi ankimor 2: OE ankues pretendon se kërkesa e AK-së për katalog ku përmendet “kualiteti i lartë dhe të njohura nga kompanitë prodhuese të pranueshme për cilësi” është në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe lenë hapësirë për vlerësime subjektive gjatë vlerësimit.

Pretendimi ankimor 3: OE ankues pretendon se specifikimet teknike të detyrueshme për disa pajisje në Lot 1 nuk korrespondojnë me standardet elementare të pajisjeve të kërkuara, disa janë të paqarta si dhe fikse pa tolerance apo ekuivalencë.

Përgjigje e Autoritetit Kontraktues në pretendimet ankimore të OE “Agri Bau Sh.P.K.”

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësi kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe paralogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet,

specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese. Për këto arsye është refuzuar si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Lidhur me pretendimin nr. 1: kërkesa për agronom dhe specialist janë kërkesa të domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës që synohet të lidhet për këtë aktiviteti të prokurimit. Kërkesat për staf profesional nuk janë të ndërlidhura me llojin e kontratës për shërbime, për punë apo për furnizim por janë të ndërlidhura me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe nevojat e njësisë kërkuese si dhe me dispozitat ligjore në fuqi të ndërlidhura me këtë çështje. Në rastin konkret këto kërkesa jo vetëm që janë të nevojshme por janë të domosdoshme dhe për këto arsye pretendimet ankimore të parashtruesit janë të pabazuara në tërësi.

Lidhur me pretendimin nr. 2: nëse aludimi i parashtruesit në këtë rast është që cilësia e pajisjeve nuk duhet të jetë e lartë, atëherë duhet cekur se ky aktiviteti i prokurimit zhvillohet pikërisht me qëllimin që pajisjet të jenë të cilësisë së lartë. Duhet shtuar se i gjithë pretendimi bazohet te ky aludim pasi që parashtruesi në asnjë rast nuk ka propozuar se si po u deshka që të formulohet një pretendim i tillë të cilin po e konteston në këtë formë duke e quajtur joprofesionale, etj. Parashtruesi ka pasur mundësinë që të propozoj një formulim tjetër mirëpo duke marrë parasysh faktin se nuk e ka bërë këtë veprim, atëherë aludimi i parashtruesit se pajisjet duhet të jenë të cilësisë së ulët dhe jo të cilësisë së lartë është aludim/pretendim tërësisht i pabazuar dhe aspak racional apo logjik.

Lidhur me pretendimin nr. 3: të gjitha specifikat teknike të detyrueshme janë hartuar në mënyrë të saktë, konkrete dhe në përputhje të plotë me qëllimin e aktivitetit të prokurimit si dhe nevojat e njësisë kërkuese. Prandaj këto specifika si të tilla janë absolutisht të domosdoshme për të realizuar me sukses kontratën që synohet të lidhet përmes këtij aktiviteti të prokurimit. Parashtruesi nuk e kontestuar në mënyrë të argumentuar këtë fakt. Rrjedhimisht edhe ky pretendim është i pabazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 17/07/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 634/2024, i cili është dorëzuar me datë 26/07/2024

Lidhur me pretendimet e OE "N. P.T. "Haxhijaha" Sh.p.k eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/634 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon: AK tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 kërkon një agronom të diplomuar dhe licensuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe zhvillimit Rural për dhënien e këshillave për fermerë derisa kërkesa në DT është furnizim me pajisje makinerike kjo bie në kundërshtim me natyrën e furnizimeve. Këtu njësia kërkuese e AK do duhej të kërkonte inxh.dip.të Makinerisë sepse furnizimet do të jenë komplet makinerike dhe nuk është detyrë e furnizuesit të pajisjeve makinerike të siguroj në stafin e vet agronom dhe ky pretendim ankimorë i OE është pjesërisht i qëndrueshëm.

Konstatimi i dytë (II): Shpjegimi i ekspertit teknik është si në vazhdim: AK tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 kërkon katalogë me specifika dhe informata të mjaftueshme për vlerësim dhe kërkon që cilësia e produkteve të jetë e lartë. Këtu fillimisht duhet që kërkesa të jetë e qartë dhe të kërkohet katalogu i prodhuesit me të dhëna teknike detale duke përfshi edhe standardet me certifikata të prodhuesit me të cilin oferton dhe kjo rrjedhimisht do të sigurojë konkurrencën e lirë të OE e cila përcaktohet qartë me nenin 19 tek specifikimet teknike, 19.4 Përshkrimi i specifikimeve teknike/Termat e referencës do të jenë të qarta, sakta dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të pa arsyeshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Specifikimet duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë paqartësi rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara. Prandaj bazuar në ato që u cekën me lartë eksperti teknik konsideron këtë pretendim të bazuar.

Konstatimi i tretë (III): Eksperti shqyrtues, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon: është si në vazhdim kjo kërkesë tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2 që të dërgon specialist të mbjelljes së fidanëve këtu duhet që të qartësohet se për çfarë specialisti bëhet fjalë, a kërkohet agronom (nëse po vlen ajo që u sqarua në pretendimin 1) apo kërkon tjetër specialist se si funksionon pajisja makinerinë dhe të siguroj inxh.të makinerisë .Prandaj bazuar në këto që theksuam me lartë ky pretendim konsiderohet i bazuar. Shpjegimi i ekspertit teknik është si në vazhdim: me datën 23.07.2024 ju kemi drejtuar AK me shkresën se cilave tipe të pajisjeve ju kanë referuar kur kanë vendosë specifikimet teknike në DT: Deri në momentin e përgatitjes dhe dorëzimit të raportit nuk kemi marrë përgjigje nga AK.

Konstatimi i katërt (IV): Me një kalkulim të thjeshtë matematikorë shihet që ka mospërputhje sepse dihet se si vëllimi kalkulohet. $V = A \times B \times H$. Ku pas shumëzimit të këtyre vlerave nuk del kapaciteti 3.5 m³. Tek pretendimi tjetër lidhur me sistemin e komandimit edhe për këto njësi kërkuese duhet të sqarohet për cilin sistem bëhet fjalë sepse të gjitha këto ndikojnë në vendosjen e çmimeve në ofertë. Tek pretendimet tjera të OE ankues eksperti teknik sqaron se këto do të duhej të sqaroheshin në formën e nenit 19 tek specifikimet teknike të detyrueshme: 19.6 Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, është si rregull i përgjithshëm i ndaluar. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdoret në raste të veçanta, nëse referenca e tillë përcjellët me fjalët “ose e barasvlershme/ekuivalente”. Ku njësi kërkuese e AK do të duhet të referohej një prodhuesi të këtyre makinerive dhe në fund të ja përcjellë fjalët e “ose e barasvlershme/ekuivalente” dhe shumica dermuese e këtyre pretendimeve ankimore do të ishin të qarta në fazën e tenderimit. Prandaj bazuar në këto që theksuam konsiderojmë që këto pretendime janë të bazuara.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 17/07/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 653/2024, i cili është dorëzuar me datë 21/07/2024.

Lidhur me pretendimet e OE “Agri Bau SH.P.K.” eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/653 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): AK, në dosjen e tenderit tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, kapaciteti teknik dhe profesional ka përcaktuar kërkesën: “OE, duhet të ketë një agronom të diplomuar dhe të licencuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) për dhënien e këshillave për fermerë. Për LOT I & LOT II”. Më tej AK ka përcaktuar se OE-të për këtë kërkesë duhet të dorëzojnë dëshminë si vijon: “Të dorëzohet diploma e fakultetit të bujqësisë dhe certifikata e këshilltarit bujqësor e lëshuar nga MBPZHR. Kontrata e punës minimumi 1 vit sa zgjatë periudha e monitorimit.” OE ankues të njëjtin pretendim ankimor e kishte paraqitur në kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar pranë AK-së me datë 15.07.2024.

Në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK lidhur me këtë pretendim ka dhënë arsyetimin si vijon: “Lidhur me pretendimin nr. 1: kërkesa për agronom dhe specialist janë kërkesa te domosdoshme për realizimin me sukses të kontratës që synohet të lidhet për këtë aktiviteti të prokurimit. Kërkesat për staf profesional nuk janë të ndërlidhura me llojin e kontratës për shërbime, për pune apo për furnizim por janë të ndërlidhura me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe nevojat e njësisë kërkuese si dhe me dispozitat ligjore në fuqi të ndërlidhura me këtë çështje. Në rastin konkret këto kërkesa jo vetëm që janë të nevojshme por janë te domosdoshme dhe për këto arsye pretendimet ankimore të parashtruesit janë të pabazuara në tërësi.”

Në një aktivitet të ngjashëm (“Furnizim me mjete bujqësore Lot 1 Motokultivator me frezë, Lot 2- Makine për mbjellëse gruri, Lot 3- Mbjellëse të misrit, Lot 4 Frezë Bujqësore 1600mm, Lot 5- Shpërndarëse Plehu nga Plastika e pastër” me numër të prokurimit 634-24-1709-1-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues AK– “KK Klinë”), pas ankesës të paraqitur në OSHP, Eksperti shqyrtues i caktuar nga OSHP në raportin e tij kishte konstatuar ndër të tjera “.... AK aktivitetin e prokurimit e ka zhvilluar furnizim me makineri si në vijim; “Motokultivator me frez, Makine për mbjellje gruri, Mbjellëse të misrit Frezë Bujqësore 1600mm, Shpërndarës Plehu nga Plastika e pastër”, kurse kërkesa e dosjes është që OE të ketë të punësuar një Agronom i diplomuar në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë. Andaj bazuar në këtë konsideroj se kjo kërkesë duhet të hiqet nga dosja e tenderit si kërkesë minimale kriter i përzgjedhjes pasi që është në kundërshtim me nenin 51 paragrafët 1,2,3 të LPP-se për faktin se nuk ka të bëjë me natyrën e prokurimit furnizim me Motokultivator me frez, Makine për mbjellëse gruri, Mbjellëse të misrit Frezë Bujqësore 1600mm, Shpërndarëse Plehu nga Plastika e pastër. Nëse AK konsideron e natyra e furnizimeve që do të realizohet në këtë aktivitet të prokurimit është komplekse mund të kërkoj kriteret tjera që janë në harmoni me natyrën e prokurimit.”. Paneli Shqyrtues i OSHP-së në vendimin numër 2024/0263, kishte vendosur bazuar në raportin e ekspertit, dhe lidhur me këtë kërkesë në gjetjet e Panelit Shqyrtues ka konstatuar “ PSH konsideron se gjithë AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet të jenë padrejtësisht të rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme të cilat

nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në aktivitet, por jo në masë që kriteret e vendosura të shpijnë në diskriminim dhe në paqëndrueshmëri dhe kundërshtim me dispozitat ligjore....”

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 1: Eksperti sqaron se AK (njësia kërkuese dhe zyrtari i prokurimit) përgjatë analizimit të nevojave dhe planifikimit të prokurimeve duhet të sigurohen që të bëhet edhe analizimi i tregut në mënyrë që të arrihet me kohë qëllimi i AK-së për një aktivitet të prokurimit dhe kërkesat të jenë të arritshme për OE-të. Në dosjen e tenderit (Aneksi 1) AK nuk ka vendosur asnjë kërkesë apo informatë për shërbimet e këshillëdhënëse gjatë zbatimit të kontratës, gjë që nuk vërtetohet arsyetimi i AK-së në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. Duke qenë kështu, kërkesa shpije në diskriminim e OE ankues dhe nuk dëshmohet që është relevante dhe proporcionale me lëndën e prokurimit. Dhe si e tillë është në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 51 të LPP-së. Andaj pretendimi ankimor është i bazuar.

Konstatimi i dytë (II): Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 2: AK, në dosjen e tenderit tek kërkesat për kapacitet teknik dhe profesional, ndër të tjera ka përcaktuar kërkesën: “OE, duhet që gjatë procesit të aplikimit ta dorëzoj katalogun me informata të mjaftueshme dhe dëshmi që pajisjet me të cilat është duke aplikuar të kenë specifikat e kërkuara, të gjitha specifikat duhet të gjenden në katalogun e dorëzuar gjatë aplikimit, pasi të vlerësohen lidhur me cilësinë e pajisjeve që do t’i ofrojnë. Cilësia e pajisjeve duhet të jetë e lartë dhe të njohura nga kompanitë prodhuese të pranueshme për cilësi të prodhimit. Për LOT I & LOT II ” Më tej AK ka përcaktuar se OE-të për këtë kërkesë duhet të dorëzojnë dëshminë si vijon: “Kopja e katalogut me informata të mjaftueshme dhe dëshmi që pajisjet me të cilat është duke aplikuar të kenë specifikat e kërkuara, të gjitha specifikat duhet të gjenden në katalogun e dorëzuar gjatë aplikimit, pasi të vlerësohen lidhur me cilësinë e pajisjeve që do t’i ofrojnë. Cilësia e pajisjeve duhet të jetë e lartë dhe të njohura nga kompanitë prodhuese të pranueshme për cilësi të prodhimit. Për LOT I & LOT II ” OE ankues të njëjtin pretendim ankimor e kishte paraqitur në kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar pranë AK-së me datë 15.07.2024.

Në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK lidhur me këtë pretendim ankimor ka dhënë arsyetimin si vijon: “ Lidhur me pretendimin nr. 2: nëse aludimi i parashtruesit në këtë rast është që cilësia e pajisjeve nuk duhet të jete e larte, atëherë duhet cekur se ky aktivitetet i prokurimit zhvillohet pikërisht me qëllimin që pajisjet të jene te cilësisë se larte. Duhet shtuar se i gjithë pretendimi bazohet te ky aludim pasi që parashtruesi në asnjë rast nuk ka propozuar se si po u deshka që te formulohet një pretendim i tille te cilin po e konteston në këtë forme duke e quajtur joprofesionale, etj. Parashtruesi ka pasur mundësinë që te propozoj një formulim tjetër mirëpo duke marre parasysh faktin se nuk e ka bere këtë veprim, atëherë aludimi i parashtruesit se pajisjet duhet te jene te cilësisë se ulet dhe jo te cilësisë se larte është aludim/ pretendim tërësisht i papabazuar dhe aspak racional apo logjik..”

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 2-Eksperti sqaron se një formulim i tillë i kërkesës është i pamatshëm, relativ dhe nuk mund të vlerësohet në mënyrë objektive. Kërkesa është në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 52 të LPP-së ku përcaktohet se vetëm kriteret e matshme mund të shfrytëzohen për vlerësim. Cilësia apo përshtatshmëria e pajisjeve vërtetohet apo certifikohet nga entitete të akredituara që i referohen një standardi, ashtu sikurse përcaktohet në pikën 5, paragrafi 2 i nenit 69 të LPP-së ku thuhet: “...certifikatave të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë ose agjencitë kompetente të pranuar që vërtetojnë

përshtatshmërinë e produkteve, që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse.” Rrjedhimisht, pretendimi ankimor është i bazuar.

Konstatimi i tretë (III): Rrethanat e çështjes në lidhje me pretendimin ankimor 3: AK në aneksin 1-Specifikimet teknike të detyrueshme ka vendosur specifikimet për Lot 1 ku përfshihen 3 pajisje. Pajisja “Rimorkio për shpërndarjen e plehut organik”, specifikimet teknike ndër të tjera janë paraqitur për dimensionet “Kapaciteti: 3.5m³, Gjerësia: 150mm, Gjatësia: 320mm, Lartësia anësore: 44mm, dhe Pesha neto: Minimumi 1550kg”. Pajisja “Makinë për mbjelljen e grurit”, specifikimet teknike janë “Numri i rëndeve:16, Gjerësia e mbjelljes :2300mm, Distanca midis rëndëve: 125mm”. Pajisja “Makinë për mbjelljen e fidanëve te perimeve”, specifikimet teknike janë“ Specifikat teknike: Makinë për shtrirjen e folisë plastike, sistemit të ujitjes pikë-pikë dhe mbjellje të fidanëve të perimeve dhe sallatave dhe sistemin e trajtimit me pesticide. OE ankues të njëjtin pretendim ankimor e kishte paraqitur në kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar pranë AK-së me datë 15.07.2024. Në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK lidhur me këtë pretendim ankimore ka dhënë arsyetimin si vijon: “...Lidhur me pretendimin nr. 3: te gjitha specifikat teknike te detyrueshme janë hartuar ne mënyrë te sakte, konkrete dhe ne përputhje te plote me qëllimin e aktivitetit te prokurimit si dhe nevojat e njësisë kërkuese. Prandaj këto specifika si te tilla janë absolutisht te domosdoshme për te realizuar me sukses kontratën qe synohet te lidhet përmes këtij aktiviteti te prokurimit. Parashtruesi nuk e kontestuar ne mënyrë te argumentuar këtë fakt. Rrjedhimisht edhe ky pretendim është i pabazuar. Nga sa u tha me sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente te qëndrueshme për te mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar ne tërësi.”

Mendimi i ekspertit lidhur me pretendimin ankimor 3: Eksperti fillimisht sqaron se lidhur me pretendimin për pajisjen “Rimorkio për shpërndarjen e plehut organik”, dimensionet e pajisjes ku kërkohet kapacitet 3.5m³, gjerësia:150mm, gjatësia: 320mm, lartësia anësore: 44mm, nuk kanë kuptim dhe janë në shpërputhje me njëra tjetrën. Një pajisje me dimensione të tilla (150mm x 320mm x 44mm) edhe po të jetë nga çeliku dhe me densitet të plotës, peshën totale do të kishte 16.6 kg. Për me tepër dimensionet janë në shpërpushje të plotë edhe me kapacitetin e kërkuar.

Më tej lidhur me dimensionet e pajisjes “Makinë për mbjelljen e grurit”, ku kërkohet që numri i rëndeve të jetë 16, distanca në mes të rëndeve 125 mm dhe gjerësia e mbjelljes të jetë 2300mm eksperti sqaron si vijon: për të llogaritur gjatësinë totale të segmentit (gjerësisë së mbjelljes) me pika të vendosura në distanca të barabarta (rende), mund të përdorim formulën: Gjatësia totale=(Numri i intervaleve)×(Distanca ndërmjet pikave). Në këtë rast, segmenti ka 16 pika (rende), por kjo nënkupton se ka 15 intervale ndërmjet tyre (sepse një segment me 2 pika ka 1 interval, një segment me 3 pika ka 2 intervale, etj.). Distanca ndërmjet çdo dy pikave është 125 mm. Numri i intervaleve=16–1=15, Gjatësia totale=15×125mm =1875mm. Duke parë llogaritjen e mësipërme, sipas dimensioneve të dhëna, gjerësia mund të ketë kuptim nëse gjerësia e rëndeve është maksimum 30mm.

Në fund, lidhur me pajisjen “Makinë për mbjelljen e fidanëve te perimeve” për të cilën AK në specifike ka përcaktuar se makina duhet të ketë funksionet për shtrirjen e folisë plastike, sistemin e ujitjes pikë-pikë, mbjelljen e fidanëve dhe sallatave, si dhe sistemin e trajtimit me pesticide, OE ankues përveç pohimit se asnjë nga mekanizmi bujqësor për mbjellje nuk posedon edhe sistem spërkatje me pesticide nuk ka paraqitë ndonjë provë për të mbështetur një pretendim të tillë. Poashtu edhe AK në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nuk ka argumentuar se një pajisje e tillë multifunksionale ekziston në treg.

Në përfundim, eksperti sqaron se AK duhet ti rishikojë specifikimet teknik për pajisjet e sipërpërmendura në mënyrë që të jenë reale dhe të qarta, dhe sigurojnë konkurrencën gjithmonë duke plotësuar nevojat e AK-së. Gjithashtu, AK duhet të sigurohet se ekziston me shumë se një prodhues, përkatësisht OE që ka në dispozicion pajisje të tilla multifunksionale. Andaj, pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët procedurale përmes sistemit të e-prokurimit ku autoriteti kontraktues nuk ka deklaruar me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës ndërkaq operatori ekonomik është pajtuar me mendimin e dhënë të ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit në platformën e e-prokurimit, pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes, konsideron se raportet e ekspertizave me nr. 2024/0634 dhe 2024/0653 i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues bazuar në analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara rrjedhën dhe analizën procedurës së prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ja fal besimin konstatimeve të ekspertëve shqyrtues të pasqyruara në raportet e ekspertizave me nr. 2024/0634 dhe 2024/0653, pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish dhe vlerëson se AK nuk ka përpiluar dosjen e tenderit në harmoni me LPP përkatësisht nenin 27 dhe 28 të këtij ligji, andaj paneli shqyrtues vlerëson se AK duhet ta kthejë procedurën e prokurimit për përmirësim dhe ta zgjasë afatin e tenderimit konform nenit 53 të LPP.

Autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

-Përfundim-

Bazuar në kompetencat e OSHP-së të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP-së, Paneli Shqyrtues vuri në të tjerat e tjera dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të gjitha palëve të interesuara do të kenë të drejtë të barabartë në procedurat e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet që të diskriminojë ose dëmtojë një person tjetër në proces ose të një personi ose ndërmarrje.

OSHP niset nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon njohurinë e plotë në ushtrimet e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitetin e buxhetit. Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe duke i administruar me kujdes të gjitha provat e bashkëngjitura në shkresat e kësaj lënde, Paneli Shqyrtues ka qëndruar si në dispozitiv të vendimit të marrë, i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur konform ndikimit në dhe natyrës së çështjes në rastin konkret duke e konsideruar po ashtu të drejtë dhe të arsyeshme edhe lejimin e mjeteve të deponuara në emër të tarifave ankimore, për të dy ankuesit.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankesës të OE, vendosi ti kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4. 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - N. P.T. " Haxhijaha" Sh.p.k., AGRI BAU SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: